



**VENDIM**

**Nr. 23 Datë 10.03.2011**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC – VLUSHE” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.03.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC – VLUSHE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “HEC – VLUSHE” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “HEC – VLUSHE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec – Vlushe” me kapacitet 14.2 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

*VENDIMIN*

*Nr. 23 Datë 10.03.2011*

**PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC – VLUSHE” SH.P.K NË**  
**AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____